

Në shtetet e rajonit në përgjithësi ekzistojnë ligje solide për të luftuar korrupsionit, por mbetet çështja e hapur se të njëjtat respektohen deri në fund për të zbutur këtë problem të madh shoqëror dhe ekonomik

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 13 dhjetor - Në shtetet e rajonit në përgjithësi ekzistojnë ligje solide për të luftuar korrupsionit, por mbetet çështja e hapur sa të njëjtat respektohen deri në fund për të zbutur këtë problem të madh shoqëror dhe ekonomik. Në këtë drejtim krahas llogaridhënies më të madhe se si harxhohen paratë publike në prokurimet e ndryshme, nevojitet edhe vullneti më i madh politik, por edhe presion dhe vëmendje më e madhe opinionit publik në drejtim të luftimit të mitmarrjes, për shkak se kjo betejë nuk i takon vetëm institucioneve përkatëse por edhe opinionit publik. Kjo ndër të tjerash u theksua të enjten në Shkup në konferencën rajonale kushtuar mekanizmave të antikorrupsionit dhe palëve të prekura në këtë proces.

"Problemi kryesor tek korrupsioni është se ai paraqet një çështje serioze që shkatërron besimin tek institucionet dhe tërë sistemin e një shteti. Sprova që të kyçemi në korrupsion është e njëjtë tek të gjitha shtetet pa dallim, a ekzistojnë legjislacioni, vullneti politik apo mjaftueshëm presion publik që ta pengoni atë. Një nga pasojat e korrupsionit në furnizimet publike është edhe rritja e kostos së harxhimeve është dhe humbja e mjeteve publike në interes të individëve si dhe ulja e cilësisë së shërbimeve", thotë ambasadori i BE-së në Shkup, Samuel Zhbogor.

Sipas tij, furnizimet publike paraqesin edhe kapitujt e parë të fillimit të negociatave me BE-në për anëtarësim, duke marrë parasysh se me Serbinë dhe Malin e zi ishte pikërisht kapitulli pesë që u hap ndër të parët, ndërsa edhe me Maqedoninë në procesin e skringut, ndër të parët ishte kapitulli pesë.

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT PA EFEKTE

VULLNETI POLITIK DHE TRANSPARENCA, TË PAMJAFTUESHME



EDUKIMI FINANCIAR I OPINIONIT

"Në këtë betejë një rëndësi të madhe kanë njohuritë financiare dhe edukimi financiar i opinionit publik ku ekziston nevoja që populli sa më shumë të fitojë njohuri së paku elementare financiare që të mund të ndjekë harxhimin e të hollave publike. Në këtë drejtim do të ndihmojnë edhe zgjidhjet softuerike për rritjen e transparencës", nënvizoi ministri i Financave, Tevdovski

Zhbogor shtoi se investimi në projektet publike ka një rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik dhe social të çdo shoqërie, por vetëm me kusht që të hollat e qytetarëve të investohen në projekte infrastrukturore që do ti shërbejnë popullit si shkolla, spitale apo rrugë.

"Nëse shëtisni nëpër Shkup do shikoni se kjo ishte rasti në vitet e fundit. Këto projekte kanë buxhete të mëdha dhe nënkuptojnë edhe plane komplekse për ti përfunduar. Nga ana tjetër këto projekte, duke pasur parasysh buxhetet e mëdha sigurojnë edhe mundësi të mëdha për korrupsion, andaj hetimet e Prokurorisë Special ofrojnë shembuj të shumtë se si janë ndarë marrëveshje për shkak të lidhjeve të afërta me partinë në pushtet, ose se si disa kompani midis tyre kanë aranzhuar konkurrencën që të ndajnë ku laçin", shtoi më tej Zhbogor.

Nga ana tjetër ministri i Financave, Dragan Tevdovski, tha se kjo qeveri angazhohet për transparencë maksimale me qëllim që opinion të jetë kontrollor i furnizimeve publike. Në këtë drejtim janë hapur tërësisht edhe të dhënat për buxhetin dhe realizimin e tij, ndërsa planifikohet edhe rritja e llogaridhënies lidhur me "trezorin", apo arkën e shtetit.

rajoni thonë se ekziston nevoja e madhe që shtetet në Ballkanin perëndimor ti kushtojnë rëndësi më të madhe harxhimit të parave publike.

"Falë angazhimit të qeverisë së Kosovës, ne si shtet i kemi ligjet më të avancuara për të luftuar korrupsionin në rajon, megjithatë mbetet çështja e hapur dhe e debatueshme se sa tek ne por edhe në rajon zbatohen në praktikë ligjet e ndryshme për të luftuar korrupsionit. Edhe pse në Kosovë kemi edhe procedura të ndryshme të ngritura lidhur me keqpërdorimin e parave publike, megjithatë në këtë drejtim nevojitet një angazhim më i madh", thotë Diana Metushi-Krasniqi, nga KDI. Nga ana tjetër, Jasna Filipoviç, nga koalicioni "Balkan tender voç", thotë se në vitet e kaluara në fqinjësinë tonë përmes anekseve është rritur çmimi i tenderëve për pesë herë, kur ka filluar të zbehet kjo praktikë korrupsioni ka gjetur teren tjetër, andaj shtetet në rajon çdo herë duhet të jenë disa hapa para, keqpërdoruesve të parave publike.

Ndryshe vlera e tenderave në vitin e kaluar në Serbi ishte 2.8 miliardë euro, në Bosnje e Hercegovinë ishte 1.1 miliardë euro, në Maqedoni ishte 625 milion euro, në Mal të zi ishte 52 milion euro dhe në Kosovë ishte 460 milion euro.

Fillon aplikimi për subvencione për peshkim

Shkup, 13 dhjetor - Ka filluar aplikimi për subvencione për të gjitha subjektet të cilët kanë prodhuar ose shitur peshk nga prodhuesit e tyre në tregje. Aplikimet mund të dorëzohen deri më datën 27 të këtij muaji, ndërsa ato kërkesa të cilat do të dorëzohen pas këtij afati, nuk do të shqyrtohen.

Nga Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural informojnë se mjete nga ky program mund të marrin subjekte të cilët kanë blerë material

për pllenim të peshqve në periudhën prej 1 shkurtit deri më 30 shtator të këtij viti ose peshkun e prodhuar në basenet e peshqve e kanë shitur në periudhën prej 1 nëntorit të vitit 2017 deri më 31 tetor të këtij viti.

Drejtori i Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Nikollçe Babovski thotë se deri në 300 mijë denarë për shfrytëzues mund të marrin ata subjekte të cilët kanë blerë peshq të rinj ose vetë e kanë prodhuar dhe

plenuar. Mbështetje financiare iu takon edhe subjekteve të cilët kanë prodhuar dhe shitur peshq në tregjet, ndërsa në periudhën prej dhjetorit të vitit 2017 deri në dhjetor të këtij viti nuk kanë importuar peshk të gjallë. Subvencionet do të ndahen në mënyrë të përkallëzuar varësisht nga kapaciteti i basenit të peshkut.

"Basenet e peshkut të cilët kanë prodhuar dhe plenuar deri 25 mijë kilogramë do të fitojnë 100 për qind subvencione nga 20 denarë

për një kilogram peshk të prodhuar. Ato subjekte të cilat kanë plenuar ose prodhuar nga 25.000 deri 50.000 kilogramë do të fitojnë 75 për qind subvencione për 20 denarë peshk të shitur, përderisa për subjektet deri në 100.000 kilogramë subvencion është 50 për qind prej 20 denarë për peshk të shitur. Më të vogël, gjegjësisht 25 për qind subvencion do të marrin subjektet të cilët kanë mbi 100.000 kilogramë peshk të plenuar ose të prodhuar", sqaron Babovski.



Gjoha për 23 shoferë që kanë folur në celular

Shkup, 13 dhjetor - Një shofer është lënduar rëndë, ndërsa një tjetër është lënduar lehtë në gjithsej shtatë fatkeqësi komunikacioni të cilat kishin ndodhur natën e kaluar në rajonin e Qytetit të Shkupit. Në pesë fatkeqësi komunikacioni ishin shkaktuar dëme materiale. Nga komunikacioni janë përjashtuar 43 shoferë të cilët kishin vozitur më shpejtë se sa që është e lejuar, dy shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 11 para se të pajisen me patentë shoferi dhe një fillestar. Nga komunikacioni janë përjashtuar edhe nëntë automjete të cilave iu kishte skaduar afati i patentës së shoferit. Janë sanksionuar edhe 24 shoferë për parkim joadekuat, tetë shoferë të cilët kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, një shofer i cili nuk u ka dhënë të drejtë kalimi këmbësorëve në vendkalimet për këmbësorë, tre shoferë për mos posedim të pajisjeve dimërore në automjete, 12 shoferë për mos mbajtjen e rripit të sigurimit dhe 23 shoferë për shfrytëzim të telefonit celular gjatë drejtimit të automjetit motorik. Policia e komunikacionit ka dhënë 92 dënime për parkim jo të drejtë, ndërsa me automjetin special "karotrec" janë larguar 66 automjete.

Papa më 7 maj viziton Maqedoninë

Shkup, 13 dhjetor - Kryetari i Kishës Katolike të Romës, papa Françesku më 7 maj të vitit të ardhshëm do të vizitojë Republikën e Maqedonisë, ka bërë të ditur pres shërbimi qeveritar. "Shenjësia e tij, papa Françesku duke pranuar ftesën e autoriteteve më të larta të shtetit dhe të Kishës katolike do të realizojë vizitë në Republikën e Maqedonisë më 7 maj të vitit 2019, me çka do të vizitojë Shkupin, vendlindjen e Nënë Terezës së shenjtë", thuhet në kumtesën e pres shërbimit qeveritar. Para Maqedonisë, papa Françesku prej 5 deri më 7 maj do të qëndrojë në Bullgari ku do t'i vizitojë qytetet Sofje dhe Rakovski.